



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 403/2 Prot.

Tiranë, më 10.06.2021

**V E N D I M**

**Nr. 104, Datë 10.06.2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 149, datë 10.12.2020, të paraqitur nga F.H kundër Bashkisë Klos, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe me shkresën, protokolluar me tonën me nr.1708/2, datë 17.12.2020, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me shkresën nr. 2921, datë 10.11.2020 është njoftuar nga punëdhënësi për fillimin e procedurave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për arsye se nuk plotësonte kriterin arsimor dhe kishte mospërputhje të gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës. Gjatë takimit të zhvilluar mes palëve, në datë 13.11.2020, ankuesi ka informuar punëdhënësin se ka mbaruar shkollën për “Agronomi” dhe ka hapur proces gjyqësor (kërkesë padi datë 04.11.2020) për të saktësuar datëlindjen në dokumentin shkollor, që i është vendosur gabim nga administrata e shkollës. Bashkia Klos me Vendimin nr. 141, datë 18.11.2020 “Për largim nga detyra” ka vendosur

<sup>1</sup> Referuar Formularit të regjistrimit të Antarësisë nr. 120724, datë 27.04.2017 të subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, F.H është anëtar seksioni i fshatit Kurqel, Kurdari. Me Vërtetimin nr. 702/2, datë 19.04.2021 të lëshuar nga Bashkia Klos, vërtetohet se F.H është shpërblyer si Sekretar i Partisë Demokratike në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, në qendrën e votimit nr. 1024.

*largimin nga detyra e Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve) F.H, për arsye të mungesës së arsimit përkatës, si dhe mospërputhjes së gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës. Ankuesi shprehet se është larguar nga puna për shkak të bindjes politike. Pas largimit të tij nga detyra, Bashkia Klos ka punësuar persona të tjerë, pa arsimin profesional sikurse kërkohet në sektorin e pyjeve (P.L, Q.M, H.T, N.D dhe P.C)”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar nga ankuesi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 1708/3, datë 18.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar Bashkinë Klos duke e vënë në dijeni për fillimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Kopje të dosjes personale të F.H. (Emërimi, kontrata e punës, vlerësime performance, masa disiplinore, nëse ka, Librezë Pune, etj).
- Kopje të të gjithë procedurës së ndjekur për largimin nga puna të ankuesit.
- Kopje të urdhërit për verifikimin e dosjes individuale të punonjësit, F.H (ose të gjithë punonjësve të Bashkisë Klos).
- Kopje të plotë të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Klos.
- Kopje të përshkrimit të punës dhe të kriterit të arsimit për pozicionin e Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve).
- Kopje të dosjes personale të të gjithë specialistëve të mesëm të Sektorit të Këshillimit dhe Shërbimeve Bujqësore, Shërbimit Veterinar, Administrimit dhe Monitorimit të Pyjeve (9 punonjës).
- Informacion nëse në vend të ankuesit është emëruar një punonjës/e tjetër.
- Nëse po, një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tij/saj.
- Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve.

Me shkresën nr. 3388/1, datë 29.12.2020, Bashkia Klos dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“F.H është larguar nga detyra për arsye të mospërbushjes së kriterit arsimor, pasi nuk zotëron arsimin përkatës si Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve), ashtu siç specifikohet, pozicioni i punës në strukturën e Bashkisë Klos, si dhe nga verifikimi i dosjes personale të ankuesit, rezulton se ka mospërputhje të gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës. Bashkia Klos nuk ka dijeni që F.H është anëtar i ndonjë subjekti politik. Dosjet individuale të punonjësve janë verifikuar nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në përmbushje të detyrave funksionale të saj dhe në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, për sa i përket përputhjes së kriterëve të zotëruara me ato të kërkuara. Gjithashtu, informohet se në vend të ankuesit është emëruar një punonjës tjetër, me arsimin profesional, sikurse kërkohet në sektorin e pyjeve, H.T. Për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra, dhe konkretisht 4 punonjës (F.D, H.K, Q.R dhe S.C)”*.

Subjekti ankues me shkresën protokolluar me tonën me nr. 195, datë 29.01.2021, ka informuar Komisionerin se, Gjykata e Shkallës së Parë Mat, lidhur me padinë e tij për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara, me Vendimin nr. 11, datë 19.01.2021, ka vendosur: - Pranimin e kërkesë padisë. – Detyrimin e Bashkisë Klos t’i paguajë F.H dëmshpërblim me 12 paga mujore, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës. - Detyrimin e Bashkisë Klos t’i paguajë F.H, 3 pesëmbëdhjetëditësha pagë për vjetërsi në punë.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 149, datë 10.12.2020, Komisioneri

me shkresën nr. 403, datë 02.03.2021 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 16.03.2021, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:

- Kopje të urdhërit për verifikimin e dosjes individuale të punonjësit, F.H (ose të gjithë punonjësve të Bashkisë Klos).
- Kopje të përshkrimit të punës dhe të kriterit të arsimit për pozicionin e Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve).
- Kopje të dosjes personale të të gjithë specialistëve të mesëm të Sektorit të Këshillimit dhe Shërbimeve Bujqësore, Shërbimit Veterinar, Administrimit dhe Monitorimit të Pyjeve (9 punonjës).
- Subjekti ankues të sjellë kopje të vendimit të gjykatës lidhur me kërkesë padinë e bërë në datë 04.11.2020 (nëse ka).

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, F.H dhe përfaqësuesja me prokurë, avokate S.P dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësueses së Bashkisë Klos, znj. E.M me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore<sup>3</sup>.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Subjekti ankues, deklaroi<sup>4</sup> se largimi i tij nga puna nuk ka qenë si rezultat i një gabimi material në diplomën e shkollës së mesme, por ka qenë për shkak të bindjes së tij politike, pasi ka aktivitet politik si anëtar në komisionin e qendrës së votimit në fshatin Kurdari. Gjithashtu, ankuesi informoi se janë marrë në punë punonjës me arsimin jo përkatës si ekonomist, topograf dhe teknik minierash<sup>5</sup>.

Përfaqësuesja e Bashkisë Klos, deklaroi<sup>6</sup> se pas verifikimit të dosjes së F.H është vënë re se nuk plotësonte arsimin përkatës për të qëndruar në vendin e punës si specialist i mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor, pasi arsimi që duhet është teknik i mesëm pyjesh. Duke pasur parasysh këtë si dhe mospërputhjen e gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës ka filluar procedura për largimin nga puna të F.H. Në strukturën e re ka ndryshuar emërtesa, nga inspektor pyjesh që nuk ka pasur të specifikuar arsimin, në specialist i mesëm pyjesh.

Në përfundim të seancës dëgjimore, nga ana e institucionit të Komisionerit u la si detyrë Bashkisë Klos që të dërgonte informacion dhe dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës, lidhur me përshkrimin e punës dhe arsimin përkatës për pozicionin, specialist i mesëm në shërbimin pyjor dhe ndryshimet e strukturës së bashkisë nga viti 2019 e në vijim.

<sup>3</sup> Referuar autorizimit nr. 584/1, datë 12.03.2021 të lëshuar nga Bashkia Klos.

<sup>4</sup> Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 10.30.

<sup>5</sup> Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 11.00.

<sup>6</sup> Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 15.40 dhe 25.30.

Përfaqësuesja e Bashkisë Klos me e-mail-in datë 18.03.2021 ka dërguar dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore.

- **Lidhur me procedurat gjyqësore të filluara nga ankuesi për largim nga puna dhe për njohjen e pavërtetësisë së pjeshme të dokumentit shkollor (amza).**

Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga ankuesi, rezulton se: F.H duke mos rënë dakord me Vendimi nr. 141, datë 18.11.2020 “Për largim nga detyra”, i është drejtuar me kërkesëpadi, Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në të cilën ka kërkuar: - Detyrimin e palës së paditur ta dëmshpërblejë në masën e 12 pagave mujore si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. - Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit shpërblim për vjetërsi në punë për periudhën 09.03.2017-18.11.2020.

Gjykata e Shkallës së Parë Mat me Vendimin nr. 11, datë 19.01.2021, ka vendosur: - Detyrimin e palës së paditur Bashkia Klos t’i paguajë paditësit F.H, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, dëmshpërblim me 12 paga mujore. – Detyrimin e palës së paditur Bashkia Klos t’i paguajë paditësit F.H, për vjetërsi në punë 3 pesëmbëdhjetëditësha pagë.

Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga ankuesi, rezulton se: F.H me kërkesëpadinë datë 04.11.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ka kërkuar: - Njohjen e pavërtetësisë së pjeshme të dokumentit zyrtar Amza me nr. 844, të Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shaban Çollaku”, Klos, përsa i përket datëlindjes 14.05.1967, shënuar gabim në këtë akt.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat me Vendimin nr. 40, datë 26.02.2021, vendosi: - Pranimin e padisë së paditësit F.H. – Njohjen e pavërtetësisë së pjesëshme të dokumentit zyrtar Amza me nr. 844, e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shaban Çollaku”, Klos, në emër të paditësit F.H, përsa i përket datëlindjes 14.05.1967, shënuar gabim në këtë akt, duke e korigjuar atë, në të vërtetë që është 16.07.1966.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pafavorshëm dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit.**

*Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:*

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ankuesi F.H ka qenë punonjës pranë Bashkisë Klos. Marrëdhëniet e tij të punës pranë Bashkisë Klos kanë filluar në datën 09.03.2017 dhe kanë vazhduar deri në datën 18.11.2020, fakte këto që rezultojnë të provuara nga aktet shkresore. Fillimisht ankuesi ka filluar punë në pozicionin Inspektor pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor (Vendimi nr. 13/1, datë 09.03.2017). Më pas në datën 01.02.2018 ankuesi ka kaluar në pozicionin Polic Pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor (Vendimi nr. 39, datë 01.02.2018). Me ndryshimin e strukturës organizative të Bashkisë Klos, më datë 15.10.2019, emërtimi i pozicionit të punës Polic Pyjesh, u ndryshua në Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve). Në përfundim, ankuesi është larguar nga detyra me Vendimin nr. 141, datë 18.11.2020 të Kryetarit të Bashkisë Klos.

Rezulton se me shkresën nr. 2921, datë 10.11.2020 të Kryetarit të Bashkisë *“Njoftim për fillimin e procedurave për zgjidhjen e marrëdhënies së punës”* ankuesi është njoftuar se duhet të paraqitet në datë 13.11.2020 për bisedime paraprake, për t’u shprehur dhe për t’u dëgjuar lidhur me pretendimet e tija. Referuar procesverbalit nr. 2921/1, datë 13.11.2020 të mbajtur mes palëve lidhur me takimin, Bashkia Klos ka informuar ankuesin se ka filluar procedura për ndërprerjen e marrëdhënies të punës, për arsye se nuk plotëson kriterin arsimor për pozicionin e punës, pasi nga verifikimet e dosjes individuale rezulton që nuk ka arsimin përkatës në pozicionin aktual të punës, dhe ka mospërputhje të gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës. Gjatë këtij takimi ankuesi ka pretenduar se: *“Ka mbaruar shkollën për Agronomi dhe për mendimin e tij është shkolla përkatëse për pozicionin e punës dhe lidhur me mospërputhjen e gjeneraliteteve të dokumentit të shkollës, sapo është njoftuar ka hapur proces gjyqësor dhe largimi nga puna nuk është i drejtë pa mbaruar procesi gjyqësor. Është emëruar në pozicionin që mban me vendim dhe ka zbatuar me korrektësi detyrat e tija”*.

Rezulton se me shkresën nr. 2921/2, datë 18.11.2020, Kryetari i Bashkisë Klos ka nxjerrë Vendimin nr. 141, datë 18.11.2020, për largimin nga detyra të Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve) të F.H, për arsye të mungesës së arsimit përkatës, si dhe të mospërputhjes së gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës.

Ankuesi e kundërshton arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur për shkak të bindjeve politike, pasi ai është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike. Për këtë arsye sqarimi i fakteve dhe rrethanave në të cilat është marrë vendimi i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, i shërbejnë qëllimit për të gjykuar mbi vërtetësinë e motivacionit të largimit nga puna të deklaruar nga punëdhënësi.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, përcakton se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjet politike, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në pikën 5, germa “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet se: “*Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën*”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit e marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor dhe mospërputhjes së gjeneraliteteve në dokumentin shkollor.

Bashkia Klos ka mbajtur qëndrimin se largimi nga puna i ankuesit është bërë për shkak se ai nuk përmbush kriterin arsimor, sipas parashikimit të nenit 7, pika 3/1 të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 *“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”*, i ndryshuar. Në këtë nen parashikohet se: *“3/1. Bashkia ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kollusor brenda kufijve territorialë administrativë, me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor”*.

Nga aktet e administruara, rezulton se parashikimi i mësipërm ka qenë në fuqi në momentin kur është punësuar F.H, në datë 09.03.2017. Pra që në kohën kur ka filluar punë ankuesi, Bashkia Klos ka qenë në dijeni të parashikimit ligjor të mësipërm dhe të arsimit të mesëm të ankuesit kur ka vendosur të emërojë F.H në pozicionin Inspektor pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor, të Bashkisë Klos. Gjithashtu, dhe më pas, Bashkia Klos ka vazhduar marrëdhëniet e punësimit me F.H dhe në momentin<sup>7</sup> kur e ka emëruar në pozicionin, Polic Pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor në Bashkinë Klos dhe në periudhën kur ka ndryshuar emërtimi në specialist i mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor.

Me ardhjen në detyrë të Kryetarit të ri të Bashkisë Klos, pas zgjedhjeve të datës 30.06.2019, është bërë ndryshimi i strukturës dhe organigramës së Bashkisë Klos. Kështu Sektori i Shërbimit Pyjor i cili përbëhej nga 9 persona (1 përgjegjës sektori, 3 inspektor pyjesh dhe 5 polic pyjesh), me Urdhrin nr. 160, datë 15.10.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së ndryshuar të Bashkisë Klos”*, u ndryshua dhe u bë me 12 punonjës (1 shef sektori, 2 specialistë të lartë dhe 9 specialistë të mesëm).

Referuar dokumentacionit të depozituar, rezulton se Bashkia Klos pas miratimit të strukturës së re, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me 3 punonjës që nuk plotësonin kriterin arsimor, pasi nuk kishin arsimin e mesëm. Kështu, Bashkia Klos pas verifikimit të dosjeve individuale të punonjësve të Sektorit të Shërbimit Pyjor, ka vendosur:

- Me Vendimin nr. 125, datë 18.11.2019, të largojë nga detyra e Polic Pyjesh, z. F. D, për arsye të mospërmbushjes së kriterit arsimor (pa arsim të mesëm). F. D nuk është paraqitur në takim.
- Me Vendimin nr. 126, datë 18.11.2019, të largojë nga detyra e Polic Pyjesh, z. H.K, për arsye të mospërmbushjes së kriterit arsimor (pa arsim të mesëm). Gjatë takimit H. K nuk ka ngritur asnjë pretendim.

---

<sup>7</sup> Me miratimin e strukturës organizative të bashkisë me Urdhërin nr. 18, datë 01.02.2018.



- Me Vendimin nr. 127, datë 19.11.2019, të lirojë nga detyra e Polic Pyjesh, z. Q.R, sipas kërkesës nr. 2597, datë 11.11.2019, si dhe për arsye të mospërbushjes së kriterit arsimor.

Në vijim, Bashkia Klos me Urdhërin nr. 17, datë 05.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Klos për vitin 2020”, ka bërë riorganizimin e Sektorit të Shërbimit Pyjor duke përfshirë punonjësit në Sektorin e Këshillimit dhe Shërbimeve Bujqësore dhe duke emërtuar 9 punonjësit që ishin, nga Specialist i Mesëm, në Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve), pa ndryshuar numrin e tyre. Kështu, Bashkia Klos pas verifikimit të dosjeve individuale të punonjësve të Sektorit të Shërbimit Pyjor, ka vendosur:

- Me Vendimin nr. 124, datë 24.06.2020, të largojë nga detyra e Inspektor Pyjesh, z. S.C, për arsye të mospërbushjes së kriterit arsimor (pa arsim të mesëm). Gjatë takimit z. S. C nuk ka ngritur asnjë pretendim.
- Me Vendimin nr. 141, datë 18.11.2020, të largojë nga detyra e Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve), F.H, për arsye të mungesës së arsimit përkatës, si dhe të mospërputhjes së gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës.

Nga analiza e strukturave të Bashkisë Klos, Komisioneri konstaton se, pozicioni i punës i emërtuar Inspektor Pyjesh, Polic Pyjesh sipas strukturës së vitit 2018 dhe 2019 ka qenë i pozicionuar në Sektorin e Shërbimit Pyjor, ndërkohë që edhe pozicioni i punës Specialist i Mesëm (monitorimi i pyjeve) sipas strukturës së vitit 2020 është i pozicionuar në Sektorin e Këshillimit dhe Shërbimeve Bujqësore, por nuk ka ndryshime thelbësore në emërtimin e pozicionit, pasi nga specialist i mesëm (struktura datë 15.10.2019) është ndryshuar në specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve) në strukturën e miratuar në datë 05.02.2020. Referuar detyrave të përshkruara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Klos, të vitit 2020, rezulton se pavarësisht terminologjisë së përdorur, “Specialist i Mesëm” apo “Specialist i Mesëm” (Monitorimi i Pyjeve), bëhet fjalë për të njëjtin pozicion pune dhe se funksionet e ushtruara prej tyre janë të njëjta.

Në analizë të sa më sipër, rezulton se Bashkia Klos pas miratimit të strukturës organizative ka kryer dhe në dy raste të mëparshme verifikimin e dosjeve individuale të punonjësve të Sektorit të Shërbimit Pyjor (në periudhën nëntor 2019, dhe qershor 2020) dhe nuk ka rezultuar që punonjësi F.H të mos ketë pasur arsimin e mesëm përkatës apo mospërputhje të gjeneraliteteve me diplomën. Vetëm një vit pas miratimit të strukturës së datës 15.10.2019, gjatë verifikimit të tretë të dosjeve individuale, u konstatua se F.H nuk kishte arsimin e mesëm përkatës.

Nga verifikimi i dokumenteve të dosjeve të punonjësve që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës në Bashkinë Klos në pozicionin e specialistit të mesëm (monitorimi i pyjeve), rezulton se:

- Me Vendimin nr. 32, datë 16.06.2016, z. M.L është emëruar në pozicionin Inspektor Pyjesh dhe me Vendimin nr. 29, datë 01.02.2018 është emëruar në pozicionin Polic Pyjesh. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme industriale e minierave.

- Me Vendimin nr. 34, datë 01.02.2018, z. N.B është emëruar në pozicionin Polic Pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme të përgjithshme dhe në vitin 2016 ka qenë student i vitit të III-të në Departamentin e Pyjeve të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
- Me Vendimin nr. 24, datë 01.03.2019, z. M.M është emëruar në pozicionin Inspektor Pyjesh në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka përfunduar gjimnazin.
- Me Vendimin nr. 123, datë 18.11.2019, z. Q.M është emëruar në pozicionin Specialist i Mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme të ndërtimit.
- Me Vendimin nr. 124, datë 18.11.2019, z. L.D është emëruar në pozicionin Specialist i Mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme të përgjithshme.
- Me Vendimin nr. 129, datë 01.07.2020, z. P.L është emëruar në pozicionin Specialist i Mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme bujqësore, në specialitetin, Ekonomi Kontabël.
- Me Vendimin nr. 129, datë 20.11.2019, z. P.C është emëruar në pozicionin Specialist i Mesëm në Sektorin e Shërbimit Pyjor. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme pyjore.
- Me Vendimin nr. 181, datë 23.11.2019, z. H.T është emëruar në pozicionin Specialist i Mesëm në Sektorin e Këshillimit dhe Shërbimeve Bujqësore, Shërbimit Veterinar, Administrimit dhe Monitorimit të Pyjeve. Punonjësi rezulton se ka diplomën e shkollës së mesme bujqësore në specialitetin agronomi.

Në analizë të kriterit të arsimit të punonjësve që kanë qenë dhe të emërimeve të bëra nga muaji nëntor 2019 e në vijim, rezulton se Bashkia Klos në pozicionin specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve) ka të emëruar vetëm një punonjës që ka diplomën e shkollës së mesme pyjore ndërsa shtatë punonjës të tjerë kanë arsim të mesëm dhe vetë Kryetari i Bashkisë Klos ka emëruar katër nga këto punonjës që kanë arsim të mesëm (shkolla e ndërtimit, gjimnaz, ekonomi-kontabël, agronomi) të cilët i ka konsideruar me arsim përkatës dhe ka larguar nga puna ankuesin me arsytimin se nuk ka arsimin e mesëm përkatës (shkollë e mesme në specialitetin agronomi). Vetë Bashkia Klos në vendimin e largimit të ankuesit është konfuze kur arsyeton se F.H nuk ka arsimin përkatës dhe mospërputhje të gjeneraliteteve të ankuesit me diplomën duke vënë në dyshim se diploma nuk është e F.H, që në këtë rast Bashkia duhet të kishte dhënë arsyen kryesore të largimit nga puna të ankuesit që, ose nuk ka arsimin përkatës, ose nuk i njih diplomën e shkollës së mesme dhe e konsideron pa arsim të mesëm.

Gjithashtu, rezulton se vetëm për ankuesin është marrë masa e largimit nga puna për mungesë të arsimit përkatës ndërkohë që vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit, shtatë punonjës të tjerë që kanë diplomë të arsimit të mesëm të së njëjtës kategori si dhe ankuesi.

Për të konkluduar për mënyrën se si ishte bërë monitorimi i dosjeve individuale të punonjësve, objekt shqyrtimi, për të vlerësuar se cilët nga punonjësit plotësonin kriterin e arsimit,

Komisioneri ka kërkuar nga ana e Bashkisë Klos dokumentacionin specifik në të cilin është parashikuar kriteri i arsimit për pozicionin e Specialistit të Mesëm (Monitorimi i Pyjeve).

Pavarësisht informacionit të kërkuar në mënyrë të përsëritur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ana e Bashkisë Klos, nuk u vu në dispozicion një dokument i saktë mbi kriterin e arsimit që duhet të plotësonin specialistët e mesëm (monitorimi i pyjeve), në mënyrë që KMD të mund të gjykonte që largimi i ankuesit të ishte i drejtë dhe objektiv, krahasimisht me punonjësit e tjerë të mbajtur në detyrë dhe të emëruar në vijim.

Argumentimi i Bashkisë Klos<sup>8</sup>, se largimi nga detyra i ankuesit është bërë për arsye të mospërmbushjes së kriterit arsimor, pasi nuk zotëron arsimin përkatës si Specialist i Mesëm (Monitorimi i Pyjeve) ashtu siç edhe specifikohet pozicioni i punës në strukturën e Bashkisë Klos, rezultoi i pabazuar në prova dhe fakte, por mbetet thjesht deklarativ për sa kohë nuk është depozituar asnjë dokument mbi bazën e të cilit të specifikohet specialiteti që duhet të kenë këto punonjës. Në këtë kontekst, Komisioneri, në mungesë të dokumentimit të deklarimeve të Bashkisë, e vlerëson si argument pro pretendimeve të ankuesit.

Lidhur me mospërputhjen e gjeneraliteteve në dokumentin e shkollës së ankuesit, Komisioneri vlerëson se Bashkia Klos ka qenë në dijeni të dokumentit shkollor të ankuesit, që në fillim të marrëdhënieve të punës, si dhe është vënë në dijeni të faktit që F.H kishte kërkuar në gjykatë rregullimin e mospërputhjes së datëlindjes në diplomën e tij, gjatë takimit të zhvilluar në datë 13.11.2020. Bashkia Klos pasi është vënë në dijeni të këtij fakti (mospërputhjes së datëlindjes) të ndodhur jo për faj të F.H, por dhe të faktit se ankuesi kishte rreth 3 vjet e 8 muaj punë pranë bashkisë, duhet t'i jepte kohën e nevojshme për sqarimin e situatës juridike ankuesit deri në përfundim të procesit gjyqësor, proces i cili rezultoi me rregullimin e gabimit në dokumentin shkollor të ankuesit.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyeja e deklaruar nga punëdhënësi për largimin nga puna të F.H për shkak të mungesës së arsimit përkatës, nuk rezultoi e provuar. Në këto kushte provohet se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme, pasi largimi i tij nga puna është bërë pa një shkak të ligjshëm.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Ky nen parashikon një sërë shkaqesh, por ndërkohë përcakton se lista e shkaqeve të mbrojtura mbetet e hapur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

---

<sup>8</sup> Referuar shkresës nr. 3388/1, datë 29.12.2020 të Bashkisë Klos.

të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Ankuesi ka pretenduar se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm për shkak të “*bindjeve politike*” pasi ai është aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”, bindje këto të kundërta me titullarin e institucionit të Bashkisë Klos, i cili është zgjedhur kryetar bashkie si përfaqësues i Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Referuar nenit 1, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkak i bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si shkak i mbrojtur dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

Në mbështetje të pretendimit të tij ankuesi ka paraqitur, formularin e regjistrimit të Antaresisë nr. 120724, datë 27.04.2017 të subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, që F.H është anëtar seksioni i fshatit Kurqel, Kurdari. Me Vërtetimin nr. 702/2, datë 19.04.2021 të lëshuar nga Bashkia Klos, vërtetohet se F.H ka shërbyer si sekretar në qendrën e votimit nr. 1024, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, për subjektin politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Klos u zgjodh z. I.H, mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Administrative, në nenin 80, pika 3, të tij ka përcaktuar se: “*Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme*”.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “*bindjeve politike*” të kundërta me Kryetarin e Bashkisë Klos.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm krahasuar me punonjësit e tjerë që vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit në pozicionin si specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve).

**Nga ana e Bashkisë Klos nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin kriterin e arsimit të duhur për pozicionin specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve) apo përligjnin faktin se largimi i ankuesit dhe vazhdimi i marrëdhënieve të punësimit me punonjësit e tjerë të ishte i drejtë dhe i arsyeshëm.**

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>9</sup>

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja është shprehur se: *“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimin të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm”*. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës (KEDNJ)<sup>10</sup>.

<sup>9</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discr\\_law\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf), faqet 47 dhe 49.

<sup>10</sup> *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”*.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>11</sup> “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s<sup>12</sup> që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos ketë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrojnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane<sup>13</sup> parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: “*Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht*”.

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “*Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër*”.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “*Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi*”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “*Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit*

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>12</sup> International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

<sup>13</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

*të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me...c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.*

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet për të cilat ky ligj ofron mbrojtje. Në nenin<sup>14</sup> 12/1/c) të ligjit 10221/2010, të ndryshuar, parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - “*praesumptio iuris tantum*”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS<sup>15</sup> gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti kundër të cilit drejtohet ankesa, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

---

<sup>14</sup> Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”

<sup>15</sup> Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti, i cili pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>16</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ *të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*<sup>17</sup>”.

Përsa i përket bindjeve politike të ankuesit, bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që është aktivist dhe anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Komisioneri vlerëson se, Kryetari i Bashkisë Klos, z. I.H, e ka të ekspozuar dhe të provuar aktivitetin e tij politik, pasi në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, është zgjedhur Kryetar i Bashkisë i mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Sa i përket aktivitetit politik të ankuesit, evidentohet se nga ana e Bashkisë Klos, me kërkesë të tij është lëshuar vërtetimi Nr. 702/2 prot., datë 19.04.2021, në të cilin citohet se: “*...F.H është shpërblyer, si sekretar i Partisë Demokratike në zgjedhjet e përgjithshme 2017, në qendrën e votimit nr. 1024, bazuar në urdhër shpenzimin nr. 615, datë 10.08.2017 dhe borderonë datë 07.08.2017, në shumën 2975 (dymijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë...*”.

Në këtë kuadër, pavarësisht faktit, që nga ana e Bashkisë Klos pretendohet se nuk ka patur dijeni mbi bindjet politike të ankuesit, nga dokumentacioni i administruar, rezulton që bindja politike e ankuesit është një fakt i njohur jo vetëm për shkak të ekspozimit të tij politik, por edhe për shkak

<sup>16</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>17</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).



se nga ana e Bashkisë disponohet informacion zyrtar, që ai ka shërbyer dhe është shpërblyer për faktin që ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2017, si përfaqësues i subjektit politik Partia Demokratike.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka provuar se ka bindje politike të ndryshme nga Kryetari i Bashkisë Klos.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm krahasuar me punonjësit e tjerë që vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit në pozicionin si specialist i mesëm (monitorimi i pyjeve). Ankuesi ka parashtruar në ankesë se pikërisht bindja e tij politike ka sjellë si pasojë dhe largimin e tij nga puna.

Bazuar në informacionin e administruar nga Komisioneri në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tij për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, rezulton se Bashkia Klos ka ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe me punonjës të tjerë, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit, duke pretenduar largimin nga puna për shkak të bindjeve politike<sup>18</sup>.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se, ankuesi mund të jetë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme, gjatë procedurave të ndjekura nga Bashkia Klos për zgjidhjen e kontratës së tij të punës, për shkak të bindjeve të tij politike.

Në këto kushte Bashkia Klos, kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për motive politike.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia, dështoi të provonte përpara Komisionerit se:

- Kishte ndryshuar kriterin e arsimit për punonjësit në pozicionin e specialistit të mesëm (monitorimi i pyjeve).
- Ankuesi nuk kishte arsimin përkatës, sipas parashikimeve ligjore të mirëpërcaktuara.
- Gjatë procesit të verifikimit të dosjeve kishte marrë masa për të vendosur në ligjshmëri marrëdhëniet e punësimit për të gjithë punonjësit që nuk kishin arsimin përkatës.
- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesi, që janë bindjet e tij politike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Klos, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.

---

<sup>18</sup> Ankesat e depozituara pranë KMD-së: nr. 147, datë 15.11.2019, nr. 114, datë 13.10.2020 dhe nr. 159, datë 29.12.2020.

Pra, ndërprerja e marrëdhënies së punës me ankuesin edhe pse është bërë për arsye të mungesës së arsimit përkatës, është bërë në mungesë të kriterëve të paracaktuara, të qarta dhe transparente. Punonjësit duhet të kenë dijeni në lidhje me bazën e cilave kriterë do të bazohet vendimarrja e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe një gjë e tillë nuk ka ndodhur në rastin e ankuesit. Diploma e ankuesit ka qenë e ditur që në çastin e lidhjes së kontratës së punës me F.H, datë 09.03.2017. Fakti që kjo diplomë është marrë në konsideratë nga punëdhënësi në kohën e lidhjes së kontratës, nuk i jep të drejtë punëdhënësit që gjatë ecuresë së marrëdhënieve të punës të ndryshojë kriterin e arsimit për vendin e punës, pa vënë në dijeni punëmarrësin dhe më pas ta konsiderojë si shkak të justifikuar për të zgjidhur marrëdhëniet e punës.

Mbështetur në provat e administruara dhe formularin e regjistrimit të Antarësisë nr. 120724, datë 27.04.2017 të subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë, rezultoi që F.H është anëtar seksioni i fshatit Kurqel, Kurdari. Gjithashtu, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, ankuesi ka qenë sekretar në qendrën e votimit nr. 1024, për subjektin politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”, fakt për të cilin ka patur dijeni edhe Bashkia Klos, referuar faktit që ka kryer shpërblimin e tij për këtë detyrë të ushtruar.

Referuar kontekstit social-kulturor shqiptar në qytetet me një popullsi të vogël në numër, siç është qyteti i Klosit<sup>19</sup>, mendohet që banorët të kenë njohje me njëri tjetrin, si dhe të kenë dhe dijeni lidhur me bindjet politike të tyre. Për më tepër ushtrimi i funksioneve publike në administratën e qyteteve të vogla dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet punonjësve në këto institucione mund të prezumojnë faktin që ata të kenë dijeni rreth aktivitetit politik të njëri tjetrit.

Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Bashkisë Klos, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar nga ankuesi, pra bindjet politike.

Në konkluzion sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Klos ka diskriminuar ankuesin F.H në të drejtën për punësim. Për rrjedhojë Bashkia Klos ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve në nenin 3, pika 1 dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33/10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, në nenin 33/12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuuese të shkakuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në

---

<sup>19</sup> <https://www.bashkiaklos.gov.al/bashkia-klos-2/>

vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të F.H, nga ana e Bashkisë Klos, për shkak të bindjes politike.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Klos të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Klos, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**